



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 13.5.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi, Fatmir Limaj.

Mungoi: Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hamit Mjeku-praktikant në Kuvend; Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Vlora Nushi-UNMIK-OPA; Teuta Prekazi-UNMIK; Blerta Bejtullahu-EUSR/EU office; Lekë Batalli-GLPS; Florie Uka-CRPK; Leotrim Berisha-Tribuna Channel; Marko Zakiq-RTK2; Bryan Marcus-US Embassy; Adem Gashi-US Embassy; Rrezarta Zekaj-RTK; Saniqe Jusufi-KosovaLive; Floriana Merovci-ZPRK; Alma Tafarashiku-EULEX; Gentiana Begolli-RTK; Fitore Hajdini-ZPRK; Dukagjin Maliqi-TV Rrokum; Lumni Lama-OSBE; Valmira Saraqi KTV; Besir Zyberi- Kosova Sot; Besnik Krasniqi- Koha Ditore; Petri Hysaj OSBE; Beadin Sylja- Kosovapress; Lirim Geci -Epoka e Re; Nebih Mxhuni-Radio Dukagjini; Driton Selmanaj-KDI; Leotrim Gashi-student; Mirjeta Dibrani-studente; Zana Boshnjaku-studente; Vlora Parduze-studente; Naim Jakaj-GP-VV.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.3.2015;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamentit të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.3.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.3.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamentit të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryetarja – Secili prej deputetëve, anëtar i Komisionit, e ka pasur amendamentin e propozuar nga Qeveria e po ashtu e kanë pasur edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në raport me këtë amendament. Konsideroj se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është i padrejtë dhe jo-kushtetues, pavarësisht faktit që është nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese, është i padrejtë dhe nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në vazhden e aktgjytimeve të padrejta të kësaj Gjykate, është edhe aktgjykimi për amendamentin e Gjykatës Speciale. Gjykata Kushtetuese ka humbur kredibilitetin për të bërë interpretime ose për të vlerësuar kushtetutshmërinë. Kjo vërehet hapur nëse e lexojmë aktgjykimin e Gjykatës për amendamentin e Gjykatës Speciale. Po ashtu, edhe Enver Hasani si kryetar i kësaj Gjykate, nuk ka më as integritet moral, as profesional për të bërë një interpretim tjetër. Me këtë aktgjykim, Gjykata Kushtetuese, që në fakt është shndërruar në një gjykatë partiake dhe politike, nuk ka bërë shqyrtim përmbajtjesor apo material të amendamentit, por vetëm një vlerësim konstituiiv struktural. Për këtë arsye, në pozicionin e kryetares së Komisionit për Legjislacion, do t'i paraqes qëndrimet ligjore ose juridike lidhur me këtë amendament. Po ashtu, do të shfrytëzoj rastin që t'i ritheksoj edhe një herë qëndrimet e Lëvizjes Vetëvendosje, në raport me amendamentin për Gjykatën Speciale. Gjithashtu, pas diskutimit tim, secili prej anëtarëve të Komisionit, do të ketë mundësi ta shprehë qëndrimin në raport me këtë amendament. Së pari, në amendament specifikohet qartë se fushëveprimi i Gjykatës Speciale me pretendimet e raportit të Dik Martit, i cili më pas ka arritur të bëhet edhe rezolutë në KE, sipas raportit të Martit. Gjithnjë, sipas këtij raporti, UÇK-ja ka kryer krime, trafikim organesh dhe shkon shumë larg sa thuhet se ka pasur dyshime edhe për tentim gjenocidi ndaj serbëve në Kosovë, gjë që është e kundërta me atë çfarë ka ndodhur në Kosovë, sepse dihet që gjenocid ka pasur vetëm ndaj shqiptarëve nga strukturat shtetërore, policore, ushtarake, paramilitare të Serbisë. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë luftë e drejtë për çlirim dhe përmes kësaj gjykate, ne konsiderojmë se po shtrembërohet e vërteta për luftën e UÇK-së. Institucionet e Kosovës nuk kanë marrë deri më tani asnjë veprim për ta mbrojtur luftën e UÇK-së. Përveç që e çarmatosën, tani po kujdesen që t'ia japin goditjen e fundit, atë të ndëshkimit moral dhe politik. Ky amendament vendos mbi ndërtimin e një sistemi shumë më të fuqishëm sesa vetë shteti. Krijon një sistem paralel nga Gjykata Themelore, deri te

ajo Supreme, madje edhe një organ të veçantë të Avokatit të Popullit dhe të Gjykatës Kushtetuese. Pra, do të jenë dy institucione të Avokatit të Popullit, një që do merret me disa qytetarë, e tjetri me disa të tjerë. Kështu do të ndodhë edhe me Gjykatën Kushtetuese. Gjyqtarët dhe prokurorët nuk do të emërohen sipas procedurave të parapara me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe nuk do t'i japin llogari asnjë institucioni në Republikën e Kosovës. Një shkelje tjetër e Gjykatës Kushtetuese, është që Gjykata Speciale, pa miratimin e Kuvendit të Kosovës, të ketë të drejtën që të hyjë në marrëveshje ndërkombëtare, kur dihet që Kuvendi i miraton marrëveshjet ndërkombëtare. Një shqetësim tjetër është që pjesa dërmuese e zyrtarëve të kësaj Gjykate, do të jenë të vendosur jashtë territorit të vendit ku do mbahen gjykimet, si dhe vuajtjet e dënimeve, që nënkupton edhe ekstradim të qytetarëve, pa ndonjë vendim të Kuvendit. Në Kosovë, nevojitet një sistem gjyqësor që i trajton të gjitha krimet e luftës në mënyrë joselektive, e jo një gjykatë si kjo për persekutimin e shqiptarëve në veçanti. Pra, konsideroj se kjo Gjykatë është jashtëzakonisht e dëmshme dhe e rrezikshme për të kaluarën dhe për të ardhmen e Kosovës. Shpresoj që pas diskutimeve në Komision, në fund të nxjerrim një rekomandim për seancën për mospërkrahje të amendamentit kushtetues.

Armend Zemaj – Sa i përket vlefshmërisë së amendamenteve, qofshin ato të mendimit të Kushtetutës, është mirë që të ketë më pak kualifikime politike, por të koncentrohen më shumë në atë çfarë i takon si komision kryesor, me rregulloren aktuale. Ne sot, si Komision, duhet merremi me çështje procedurale, do të thotë t'i procedojmë këto amendamente për në seancë dhe Komisioni të shkarkohet nga ngarkesa se çfarë rekomandimi duhet të japë apo mos të japë.

Kryetarja – Komisioni, në bazë të rregullores, shqyrton propozimet për ndryshimet kushtetuese. Ne atë po e bëjmë dhe po e shqyrtojmë këtë ndryshim, sepse është propozim për ndryshim kushtetues, kështu që duhet t'i rekomandojmë Kuvendit për votim ose jo dhe mendim i imi është që t'i rekomandojmë seancës plenare për mospërkrahje të këtij amendamenti.

Donika Kadaj-Bujupi – Theksoi se do jemi ndër ata deputetë të cilët do të marrin vendimin dhe ky vendim do jetë një drejtim të cilin do t'ia japim vendit, në kuptimin e asaj se a do heqim dorë nga mëvetësia, nga sovraniteti që edhe kështu është i brishtë apo do të vendosim që do të marrim vendime të drejta dhe të duhura në kuptimin e zbatimit të ligjeve të Kosovës, Kushtetutës së Kosovës, që është në fuqi dhe mos të biem pre e manovrimeve politike që kanë filluar shumë më parë, ndërhyrjeve të vazhdueshme në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimeve politike në dëm të gjyqësorit, prokurorit, drejtësisë në Kosovë, dhe mbi të gjitha, në dëm të interesave të vendit. Është paradoks të themi se këto amendamente nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën, përderisa po kërkohet një ndërhyrje substanciale në vetë Kushtetutën e vendit tonë. Kjo gjykatë, do të hetojë, akuzojë dhe do të bazohet mbi shpifjet e ngritura për UÇK-në, për njerëz të cilët mbrojtën shtëpinë e tyre, të cilët nuk shkuan ta bëjnë luftën në Beograd, por rezistuan këtu për të mbrojtur popullatën civile për një periudhë të gjatë, deri në ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe arritjen e objektiva tona, për një Kosovë të liruar nga regjimi, tortura dhe gjenocidi serb. Tani, 15 vite pas çlirimit, përkatësisht 8 vite nga pavarësia, ne po japim nga mëvetësia jonë për një proces të paragjykuar, i cili në asnjë moment nuk dëshirojmë të themi që jemi kundër hetimeve për çfarëdo supozimi për krime eventuale, mirëpo ato duhet të ndodhin brendapërbrenda gjyqësorit të Kosovës, ashtu siç ka ndodhur në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë. Serbia e cila ka kryer krimet më të rënda në ish-Jugosllavi, nuk ka asnjë gjykatë speciale, po ashtu as republikat tjera nuk kanë gjykata speciale, por kanë shfrytëzuar sistemin e

vet të drejtësisë për të vënë drejtësi eventuale në vend, andaj rikonfirmoj se qëndrimi ynë si subjekt është që të fuqizohet roli i gjyqësorit brendapërbrenda shtetit tonë, të mos heqim dorë nga sovraniteti, edhe kështu i brishtë i vendit tonë, të punojmë në shfrytëzimin e resurseve tona që drejtësia të vihet në vend, sepse që nga paslufta drejtësia ndërkombëtare dhe ajo vendore kanë punuar në mënyrë selektive, që shumë individëve të caktuar iu ka kushtuar me karrierë, me vuajtje në familje dhe i ka kushtuar Kosovës. Edhe tani, po synohet që me Gjykatën Speciale, t'i bëjnë dëm vendit tonë edhe më shumë. Kjo po dëshmohet edhe tani që publikisht prokurorë ndërkombëtarë po dalin e po tregojnë që ka pasur pazare në raste të caktuara, andaj është mirë që drejtësia vendore dhe ajo ndërkombëtare të dalin publikisht dhe të tregojnë se për çfarë pazaresh bëhet fjalë, kush i ka bërë? Kosovës po i vonohet drejtësia, sepse krimet e serbëve ende nuk janë dënuar për krimet dhe masakrat e tyre. Edhe kur janë dënuar, janë dënuar me dënime qesharake, së fundi, rasti i Qyshkut, janë dhënë dënime. Andaj, është vendim i yni që të ruajmë mëvetësinë e shtetit tonë, që mos t'i japim përkrahje kësaj gjykate, sepse do të na kushtojë shumë, dhe po ashtu, do të portretizohemi në media botërore si kryerës të krimeve dhe dihet që kjo nuk qëndron, sepse dihet forca disproporcionale në makineri. Andaj, i ftoj të gjithë deputetët, pa marrë parasysh ngjyrat politike, që mos ta përkrahim themelimin e kësaj gjykate.

Fatmir Limaj – Rrallë vjen momenti kur pesha dhe vlera e të qenit deputet dhe pesha e përgjegjësia vënë në sprovë, sikurse që ka kjo legjislaturë dhe këta deputetë që janë të zgjedhur nga populli. Janë momente të veçanta, sepse ka raste kur parlamentet shkojnë e nuk hetohen hiq as për veprim apo mosveprim dhe ka pasur legjislatura edhe tek ne që nuk mbahen mend për asgjë, sikurse që ka pasur edhe legjislatura të mira. Kjo legjislaturë është para një momenti që të lërë gjurmë direkte në ndërtimin e shtetit të Kosovës, duke u zhveshur nga ngjyrat politike të cilat vijnë. Është momenti që secili deputet të reflektojë dhe të vendosë në cilësinë e deputetit dhe përgjegjësinë që ka marrë nga besimi i qytetarëve. Pra, të gjithë deputetët do të jenë në luftë mes ndërgjegjes, dinjitetit dhe kompromisit që të vendosim se a është Parlament kukull apo Parlament i dinjitetshëm, sepse pa na shtyrë askush, pa na kërcënuar askush as me jetë, as me burg, ne kemi për të ngritur dorën për të kufizuar sovranitetin e shtetit tonë apo për të refuzuar një propozim për kufizim të sovranitetit të shtetit tonë. Në legjislaturën e kaluar, me kënaqësi kemi përjetuar largimin e mbikëqyrjes së pavarësisë, kurse sot po flitet kinse për ndryshime kushtetuese. Po këtu, ka shkrim të një pjese të Kushtetutës në thelbin e rregullimit juridiko-kushtetues. Nga ne kërkohet që ta rimbikëqyrim sovranitetin e shtetit tonë, duke kufizuar këtë sovranitet. Në negociatat e vitit 2007, kemi pasur motiv për pranimin e një pavarësie të mbikëqyruar, sepse ishim pa pavarësi dhe ishim të gatshëm të bëjmë lëshime dhe kompromise për të ardhur deri tek pavarësia. Tash, pas sa viteve pavarësi, po kthehemi përsëri në një situatë pa asnjë arsye që ta rikufizojmë statusin apo sovranitetin tonë. Kërkesa për të ashtuqajturën dhoma speciale, për mua nuk e arsyeton kufizimin e statusit, sepse nuk ka deputet në botë që ka obligim ndërkombëtar për ta ngritur dorën dhe kufizuar sovranitetin e vendit të vet, në asnjë kontratë, asnjë obligim, asgjë në botë nuk mund ta detyrojë deputetin për të ngritur dorën në emër kinse obligim ndërkombëtar për ta kufizuar sovranitetin e vendit të vet. Çdo deputet, pa marrë parasysh ngjyrën politike, e ka obligim aty ku buron sovraniteti, vetëm vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe nuk ka të drejtë Kuvendi i Kosovës ta ngre dorën që ta kufizojë sovranitetin e vet, prandaj nuk dua të merrem me Gjykatën Kushtetuese, që ka bërë lojë kinse është në pajtim me Kushtetutën, sepse këtu ka cenim të sovranitetit. Këtu duhet të vendosë populli. Propozoj që ta qesim në referendum. Me dhjetëra dekada kemi luftuar për këtë sovranitet, e tani për dëshira të disa personave, të interesave ndërkombëtare, ne po kufizojmë sovranitetin e vendit. Të gjithë

veteranët me i dërguar në burg, nuk vlejnë sa sovraniteti i Kosovës, nëse kjo çështje po thuhet se është për individë, atëherë mos ta prekim sovranitetin, sepse Kosova nuk mund ta paguajë çmimin për shkak të individit, andaj duhet prekur individin e jo sovranitetin e vendit. Nëse i shikojmë të gjitha nenet, sidomos nenin 162, kuptojmë që Kushtetuta për këtë është e pavlefshme. Pra, në nenet e propozuara, nuk ka interpretime juridike, por këtu ka dykuptimësi politike-diplomatike që lihen në duar të atyre kinse do ta zbatojnë dhe dihet se çka interpretohet. Sistemi i drejtësisë së Kosovës ka ligje, është i rregulluar me ligj, atëherë pse duhet bërë ndryshime Kushtetuese që të kufizohet sovraniteti? Këtu po ndodh suprimimi i Kuvendit, Qeverisë, Presidencës së Kosovës, që të krijohet një dhomë dhe ajo të bëjë çfarë të dojë, të na futë në obligime ndërkombëtare dhe të vendosë çfarë të dojë, në emër të Kosovës. Pra, këto nuk janë kompetenca të drejtësisë, këto janë kompetenca të një organi politik të zgjedhur të qytetarëve të Kosovës. Për dallim nga Kroacia dhe Bosnja, ne kemi pasur gjykatat ndërkombëtare, pra këtu tërësisht ndërkombëtare, të gjitha të specializuara, prej ditës së parë që janë marrë, deri më sot dhe ka qenë e drejtë ekskluzive e gjykatësve ndërkombëtarë për t'u marrë me krime lufte. Jemi i vetmi vend në rajon ku prokurori vendor nuk ka pasur të drejtë të hetojë për krime ndaj popullit të vet, pra është prokurori shqiptar i Kosovës. Pra, i vetmi vend në rajon është ku gjyqtari nuk ka pasur të drejtë të gjykojë për krime ndaj popullit të vet. Në Serbi gjykohen për krime ndaj shqiptarëve, hetohet nga prokuroria, policia serbe, janë bërë kallëzime penale nga ta, gjykohen nga serbët. Në Kroaci e njëjta situatë, po ashtu edhe në Bosnjë. Vetëm në Kosovë atë mundësi s'e kanë pasur as prokurorët, as gjyqtarët. Në Kosovë ka diçka edhe më shumë, përveç prokurorëve e gjyqtarëve ndërkombëtarë, ka pasur edhe policë hetues ndërkombëtarë. Ne nuk mund të bëhemi strehë e të gjitha dyshimeve që bëhen për vendin tonë, të drejta apo të padrejta. Mbështetjen tonë do ta kenë të gjithë ata që nuk e prekin sovranitetin e shtetit tonë, por asnjëherë, me asnjë çmim, nuk mund të më detyrojnë ta ngre dorën kundër sovranitetit të vendit tim apo kufizimit të tij. Ju ftoj që mos të lejoni të bëheni peng, për shkak të pazareve ose të njerëzve të shantazhuar, të cilët janë të dëgjueshëm të kufizojnë sovranitetin e vet, sovranitetin e shtetit të vet, vetëm e vetëm për të shpëtuar veten e tyre. Pra, duhet të ndodhë e kundërta, të japim veten për shtetin, e jo shtetin për veten.

Doruntinë Maloku – Rikujtoi nenin 19 dhe 20 të Kushtetutës ku flitet për zbatimin e së drejtësisë ndërkombëtare. Po ashtu, theksoi se nëse në Kuvend nuk miratohet Ligji për themelimin e Gjykatë Speciale, atëherë një gjë të tillë do ta bëjë Këshilli i Sigurimit. Pra, nëse nuk delegohen kompetencat ose nëse nuk delegohet sovraniteti tek dhomat e posaçme, atëherë atë do e bëjë Këshilli i Sigurimit. Kur jemi tek sistemi i drejtësisë, mund t'ju them se që 16 vite sistemi i drejtësisë ka dështuar totalisht dhe Gjykata Speciale vjen si pasojë e dështimit tonë. Ata që kanë provuar të ikin prej drejtësisë për 16 vite, ata janë shkaktarët e themelimit të Gjykatës Speciale, e jo ne. Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën e popullit për liri dhe pavarësi, nuk mund ta njollosë askush, asnjë gjykatë as këtu, e as atje. Këtu po flasim për përgjegjësi individuale për krime të pretenduara dhe ne duhet treguar se nuk i ikim drejtësisë. Ai që ka kryer krime do të dënohet si këtu, si atje.

Kryetarja – Si mund një individ të bëjë krime lufte dhe gjenocid, sepse po akuzohemi për gjenocid dhe krime të luftës?

Doruntinë Maloku – Nuk po flasim për gjenocid.

Fatmir Limaj – Theksoi se sovraniteti i një vendi bëhet kur ne bëhemi anëtar i NATO-s, bëhemi anëtar i Bashkimit Evropian. Deputetët mund ta votojnë këtë gjykatë, por nuk e di a do ta pranojë populli? Pra, kjo çështje është më shumë politike sesa juridike.

Kryetarja – Theksoi se po bëhen trillime kinse nëse nuk miratohet nga Kuvendi i Kosovës, atëherë këtë mund ta bëjë Këshilli i Sigurimit, kjo nuk qëndron. Kjo po përdoret më shumë si kërcënim për deputetët, të cilët po e kundërshtojnë Gjykatën Speciale, sepse Këshilli i Sigurimit, nëse do ta kishte të drejtën për themelimin e kësaj gjykate, ata nuk do të ushtronin presione tek deputetët tanë për ta votuar këtë gjykatë. Drejtësia ndërkombëtare po përdoret si mjet për shantazh. Pra, nuk duhet ta lejojmë ta diskreditojmë përpjekjen për çlirim dhe deputetët e kanë obligim ta mbrojnë luftën e UÇK-së. Drejtësia pa barazi është drejtësi selektive, është drejtësi e njëanshme dhe përfundon në padrejtësi.

Selvie Halimi – Kjo është një çështje shumë e ndjeshme dhe është vështirë të flitet se gjyqësori është i papolitizuar apo të flitet për ndarjen e gjyqësorit nga politika, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë botën e aq ma pak është vështirë të flitet për një pavarësi të gjyqësorit në Kosovën e pasluftës, e deri më tani. Ne mund të themi që jemi të lirë dhe të pavarësuar, por mund të themi se asnjë proces nuk e kemi kryer vetë, kemi pasur gjyqësor të UNMIK-ut, tani të EULEX-it, krahas tyre gjyqësorin e Kosovës dhe nuk u treguan të suksesshëm në procesin për të cilin sot po diskutohet. Pse nuk u treguan të suksesshëm, kush ishin ata që nuk i lejuan këta tre mekanizma që të tregohen të suksesshëm? Ne, vetë nuk i lejuam të veprojnë suksesshëm. Gjithashtu, edhe politikat e caktuara, me apo pa qëllim dhe tanimë jemi në një situatë kur Kosovës i duhet një gjykatë për çështje të caktuara, periudhë të caktuara dhe madje ka hamendje për çështje të asaj periudhe. Pa ofenduar askënd, ne jemi kontribuues të kësaj së keqe. Secili, kush në masë të vogël, e kush në masë të madhe, sepse secili në periudha të caktuara ka ditur të bëhet i mirë apo i keq në institucionin gjyqësor dhe si rezultat, na erdhi kjo gjykatë. Lus që kjo Gjykatë Speciale të jetë sprova e fundit për Kosovën. Unë shoh nga e kaluara se nuk preket sovraniteti i Kosovës, por shihet që duhet bërë më shumë për ta liruar vendin nga një e keqe të cilës i kemi kontribuar, pra kushdo qoftë ai që është mashtruar e i ka kontribuar kësaj të keqeje. Këtu, nuk ka fitore në aspektin afatgjatë, por ka fitore nëse arrijmë të spastrohet gjithë ajo dilemë, gjithë ai supozim që po bëhet për qytetarët e Kosovës, e në veçanti për UÇK-në. Për spastrimin e këtyre dilemave, duhet kontribuar ne vetë, sepse dëshirojmë që pjesëtari i UÇK-së të ndjehet ashtu qysh në fakt është çlirimtar, e jo kriminel. Nuk prish punë Gjykata Speciale, nëse ne nuk lejomë shantazhe dhe politizim të këtij procesi. Andaj, si Komision, ta procedojmë sipas Rregullores së Kuvendit, që kjo çështje të shkojë në Kuvend dhe Kuvendi të vendosë për këto amendamente.

Armend Zemaj – Theksoi se mendimin ndaj të mirave dhe të këqijave e kemi shprehur me votë, andaj edhe për këtë çështje do ta shprehim në seancë plenare, por mbi të gjitha, kërkojmë që drejtësia ta thotë fjalën e vet. Drejtësia vendore të ketë prokuror vendor shqiptar, gjyqtar shqiptar që e sjell një vendim të tillë, asnjëherë ndërkombëtar, por në fazën në të cilën gjendemi ne, do ta deklarojmë votën tonë në seancë plenare, andaj t'i përcjellim për seancë këto amendamente,

ashtu siç i takon Komisionit me Rregullore të punës së Kuvendit, sepse nuk ka nevojë tani të kemi dyshime se kush është PËR apo kush është KUNDËR.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetarja nxori dy propozime për votim:

Propozimi 1: T'i rekomandojmë Kuvendit të Republikës së Kosovës që mos të përkrahet ky amendament.

Propozimi 2: Të procedohet për shqyrtim në Kuvend, pa ndonjë rekomandim.

Në fund të debatit, Komisioni, me 6 vota për dhe 3 vota kundër, e përkrahu propozimin e deputetit Armend Zemaj.

Komisioni vendosi që amendamenti nr. 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të procedohet për shqyrtim në Kuvend, pa ndonjë rekomandim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Komisioni vendosi që në një takim të radhës, të ftojë ministren Edita Tahiri, për të marrë sqarimet e nevojshme për qëllimin e Projektligjit, para se i njëjti t'i nënshtrohet amendamentimit dhe procedimit të mëtejshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
